# A K T  T H E M E L I M I

## PER SHOQERINE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

## " A R N A " SH. P. K.

Ne te quajturit Arqile Kristo Kapurani i dlt. 1959 , dhe Nastasia Lefter Kapurani e dlt. 1962 te dy banues ne Boboshtice te Korces vendosen themelimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar : " A R N A " ShPK

**NENI 1**

Selia e ShPK " A R N A " do te jete ne Boboshtice te Korces

**NENI 2**

Kohezgjatja e veprimtarise do te jete mbi 10 vjete

**NENI 3**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 Leke

**NENI 4**

Objekti i veprimtarise se ShPK " A R N A " eshte : Rritje zogj per mish, shitje mish pule, import zogj pule, import koncentrati

**NENI 5**

Menyra e administrimit ;Organi vendimor i shoqerise eshte asambleja e ortakeve Administrator i shoqerise eshte Arqile Kapurani

**NENI 6**

Te gjitha mosmarreveshjet qe do te lindin gjate veprimtarise se shoqerise do te zgjidhen ne rruge gjyqesore ne Gjykaten e Rrethit Korce

**NENI 7**

Akti i themelimit do te bashkangjitet Statutit te shoqerise ne te cilin jane percaktuar qarte pikat kryesore ku do te mbeshtetet shoqeria

**O R T A K E T :**

1. ARQILE KAPURANI    2. NASTASIA KAPURANI

REPUBLIKA E SHQIPERISE SOTIRAQ G. QAFZEZI NOTER KORÇE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SOTIRAQ G. GAFZEZI
NOTER
KORÇE

# S T A T U T I

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

## " A R N A " SH. P. K.

Kapitali themeltar eshte 100.000 Lek.

Ortaketethemelimit jane: 1. Arqile Kapurani 2. Nastasia Kapurani.

## K R E U I

Forma. Objekti. Selia. Kohezgjatja.

### NENI 1

Krijohet ne baze te ligjit Nr. 7512 dt. 10.8.1991.
"per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private te pavarur dhe privatizimit dhe ligjitNr. 7638 dt. 19.11.1992" Per shoqerite tregetare " .
shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " A R N A " SH. P. K .

### NENI 2

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:
- Ritje zogj pule per mish, shitje mish, import zogj pule dhe koncentrat.

### NENI 3

Shoqeria " A R N A " SH. P. K. eshte person juridik shqiptar.
Kjo shoqeri fiton personalitetin juridik qe nga dita e regjistrimit te saj prane regjistrit tregetar ne Gjykates se Rrethit Tirane.

### NENI 4

Selia e Sh. P. K. " A R N A " eshte ne Bobeshtice te Korces, ajo mund te krijoje filiale dhe agjenci ne qytetin e Korces dhe ne qytete te tjera te vendit te cilat veprojne sipas legjislacionit ne fuqi.

### NENI 5

Jetezgjatja e shoqerise eshte mbi 10 vjet, me perjashtim te rasteve kur vendoset shperndarja e saj nga organi kompetent , si dhe ne rastin kur verifikohen rrethana qe parashikohen shprehimisht ne ligj.

## K R E U II

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT THEMELTAR.

### NENI 6

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 lek, dhe pjeset e paleve jane ;
1. Arqile Kapurani 50% 2. Nastasia Kapurani 50% .

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SOTIRAQ G. GAFZEZI
NOTER
KORÇE

NENI 7

Kapitali eshte i ndare ne kuota nga 1000 lek, per transferimin e te cilave tek te tretet eshte kompetent administratori i shoqerise.

Neni

K R E U III

NENI 8

ORGANET E SHOQERISE

Organi me i larte i shoqerise eshte asambles e ortakeve. Cdo vendim merre me pelqimin e te dy ortakeve dhe regjistrohet ne librin e shoqerise. Ky vendim i perbashket ka perseysh ndryshimin e neneve te statutit, rritjen ose pakesimin e kapitalit , percaktimin e perfaqesuesve te shoqerise, shperndarjen e shoqerise, kohezgjatjen e saj, ndryshimin e selise, krijimin e filialeve , marjen e kredive , miratimin e pages se punonjesve dhe cdo ceshtje tjeter qe e shikon te arsyeshme. Cdo person i interesuar mund te kerkoje ne gjykaten kompetente anullimin e vendimeve te asamblese, te mara ne kundershtim me dispozitat dhe me udhezimet eligjit dhe te ketij statuti.

NENI9

Shoqeria administrohet nga nje administrator i vetem dhe eshte zoti Arqile Kapurani i biri i Kristaq i dtl, 1959 banues ne Bobashtice KORCE.

NENI 10

Mandati i administratorit eshte 10 vjet me te drejte riszgjedhje.

NENI 11

Administratori ka te drejte te kryeje cdo veprimtari administrative ne interes te shoqerise dhe brenda objektit te veprimtarise se saj, ne marredhenie me te tretet, me perjashtim te atyre rasteve kur ligji ne menyre ekskluzive i ka caktuar asamblese se ortakeve.

NENI 12

Administratorit i takon firma e shoqerise dhe perfaqesimi isaj ndaj te trtv

NENI 13

Shoqeria mer persiper detyrimet qe rjedhin nga aktet e administratorit edhe kur keto nuk perfshihen ne objektin e veprimtarise .

K R E U IV

BILANCI DHE NDARJA E FITIMEVE

NENI 14

Cdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor. Asamblea e ortakeve cakton nje ose disa eksperte kontabel , te cilet kane detyre qe cdo fund viti te paraqesin bilancin dhe fitimet.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SOTIRAQ G. QAFEZEZI
NOTER
KORÇE

**NENI 15**

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te ekzistences se tyre asamblea e ortakeve percakton pjeset qe i takon secilit ne formen e dividenteve te fitimit . Ne rastin e SH.P.K. " A R N A " ndarja e fitimeve eshte ne masen 50 % per njerin ortak dhe 50 % per ortakun tjeter.

## K R E U V

**TE NDRYSHME**

**NENI 16**

Ne rast prishje ose pezullimi te kontrates i takon ortakut ngeles per te marre persiper vazhdimin e aktivitetit te shoqerise , ne aktivitetet dhe pasivet e saj.

**NENI 17**

Marredheniet e punes nepermjet shoqerise dhe te punesuarve , percaktohen n baze te ligjit ne kontraten kolektive e individuale te punes.

**NENI 18**

Statuti shtypet ne gjuhen shqipe , ne kater kopje.
Ortaket mbasi kuptuan te drejtat dhe detyrimet qe rjedhin nga ky statut vendosen ta firmosin ate .

## O R T A K E T

1. ARGILE KAPURANI

2. NASTASIA KAPURANI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SOTIRAQ G. QAFZEZI
NOTER
KORÇË